



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 18213/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Petrit Selimi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 18.10.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Petrit Selajdin Selimi, i lindur më 01.05.1979 ne Prishtinë, ku dhe tani jeton ne rrugën Rexhep Luci nr.6/1, zyrtar i lartë publik, zëvendës ministër në Ministrinë e Punëve te Jashtme, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtarit te lartë publik, zëvendës ministër i Ministrinë të Punëve te Jashtme, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili behtë me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve te lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) EURO. Gjohën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No.1000-4300-7000-0518 Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata. Nëse brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 dite duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) EURO në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur kurse në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) EURO në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtroi kërkesën nr.01 1835/2012 të dt 18.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marrë konkluzion.

Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i përket mbushjes se formularit për deklarimin pasurisë është se me dt. 28.03.2012 kam qenë në vizitë jashtë shtetit zyrtarisht ndërsa me herë nuk e kam mbushur këtë formula, kështu e nuk e kam mbushë me afatin këtë formular, kërkoj falje që është hera e parë por unë e kam deklaruar menjëherë pasi që jam kthyer prej vizitë, ku do të javë sjelli dëshminë që e kam mbush formularin dhe e kam dërguar në agjension.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht në kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoi këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekt pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të kësaj lloji dhe të ngjashme. andaj u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Fatmir Behrami

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.